



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d) të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04 qershor 2008), të Rregullores 01-110/05-206977/22 e dt. 26.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë

VENDIM

**PËR CAKTIMIN E KOMISIONIT PËR UDHËHEQJEN DHE KOORDINIMIN E
PUNËS NË TERREN PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE,
VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE**

- I. CAKTOHEN anëtarët e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- II. Anëtarë të komisionit si në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Feim Osmani, (anëtar i KK);
 2. Jeta Rafuna, (anëtare e KK);
 3. Leutrim Retkoceri, (anëtar i KK);
 4. Valbona Ajeti, (anëtare e KK);
 5. Bersant Beka, (anëtar nga Ekzekutivi);
 6. Donika Ahmetaj, (anëtare nga shoqëria civile);
 7. _____, (përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal).
- III. Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i komisionit janë të cekura në Rregulloren 01-110/05-206977/22 e dt. 26.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Rregulloren nr. 01-030/01-34831/18 e dt. 06.06.2018 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.
- IV. Komisioni i cekur si në pikën II të këtij Vendimi do të kompensohet në vlerë prej 300 € në muaj nga kategoria mallra dhe shërbime, për muajt sa zgjat procesi i përzgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Pas kësaj periudhe Komisioni nuk kompensohet.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/07-257562/22, më 25.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kapina

